



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES/KORRIGJUES

Kandidatët e interesuar për të marrë pjesë si hartues/korrigjues në provimet e sezonit 2020/2021 dhe që plotësojnë kriteret e rregullores “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për Auditues Ligjorë dhe Kontabilist të Miratuar”, e ndryshuar, duhet të paraqesin pranë sekretarisë teknike dokumentat si më poshtë.

Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit janë si më poshtë:

Hartuesit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Si dhe përvec pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale sëbashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatën profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).

Kriteret që duhet të plotësojnë korrigjuesit janë si më poshtë:

Korrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

c) Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Kërkesa e aplikimit së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatës profesionale IEKA dhe/ose pranë SM të BMP-së.

Dokumentacioni që duhet dorëzuar

Çdo kandidat që aplikon për hartues dhe korrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:

- a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
- b. Curriculum Vitae;
- c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
- d. Fotokopje të diplomave;
- e. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale)

Të gjithë hartuesit/korrigjuesit do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.

Dorëzimi i dokumentacionit pranohet deri ne datën 2 Dhjetor 2020.